



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:151799
Datë: 23.04.2024
Numri i dokumentit: 05608660

CA.nr.3489/24

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Hidajete Gashi Alaj dhe Ylber Shurdhiqi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Ministra e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia Pyjore e Kosovës, të cilën e ka përfaqësuar me autorizim L.S , kundër të paditurit S.B, të cilin me autorizim e përfaqëson avokati I.O, për pagim borxhi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Deçan, C.nr.59/21 e datës 06/02/2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 23/04/2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e themeltë ankesa e paditëses Ministra e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia Pyjore e Kosovës dhe ANULOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Deçan, C.nr.59/21 e datës 06/02/2024 dhe lënda kthehet në gjykatën e shkallës së parë në procedim të serishëm.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë-Dega në Deçan, me aktvendimi i ankimor C.nr.59/21 e datës 06/02/2024, ka vendosur më sa vijon:

I.Padia e paditëses Ministra e Bujqësisë ,Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia Pyjore e Kosovës kundër te paditurit S.B për kompensimin e borgjit TRAJTOHET E TERHEQUR.

II. DETYROHET paditësja Ministra e Bujqësisë ,Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia Pyjore e Kosovës qe ekspertit Financiarë B.H për hartimin ekspertizës te ja paguan shumen prej 150.00 euro ne xhirollogarinë me numër 1706017400779330 ne Bankën NLB, ne afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes te këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi, i autorizuari i paditëses në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit ta kthejë lëndën në rishqyrtim.

I padituri nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 208 dhe nenin 209 të LPK-së, ka gjetur se:

-Ankesa e të autorizuarit të paditëses është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja pranë gjykatës së shkallës së parë, me datën 07.02.2007, ka paraqitur padi kundër të paditurit, për anulimin e njoftimit, me kërkesë si në petitumin e padisë.

Gjykata e shkallës së parë lidhur me këtë çështje juridike ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor me datën 06.02.2024 në ora 13:30, që përfaqësuesi i paditësit L.S ka qenë i njoftuar me kopje të procesverbalit të seancës paraprake të shqyrtimit kryesor të mbajtur me datën 07.12.2023, që për gjykatën ka shërbyer si ftese në mënyrë të rregullt. Ndërsa përfaqësuesi i paditësit i lartshënuar nuk ka ardhur dhe për arsyen e mos ardhjes nuk e ka njoftuar gjykatën me ndonjë parashtesë me shkrim dhe mbi bazën e këtyre arsyeve ka vendosur si në dispozitivin e aktvendimit të atakuar duke u bazuar në nenin 423 par.3 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm pasi që aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 e lidhur me nenin 423.3 të LPK-së.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, pas analizimit dhe shqyrtimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, në raport me pretendimet ankimore erdh në përfundim se ankesa e paditëses është e bazuar, për arsye se gjykata e shkallës së parë në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datën 07/12/2023, ka marr vendim që seancën e radhës të caktoj me datën 06/02/2024 në ora 13.30 min dhe ky komunikim palëve ndërgjyqëse ju ka shërbyer në vend të thirrjes së rregullt, por të njëjtit nuk kanë prezantuar dhe si rezultat padia e paditëses është konsideruar e tërhequr, edhe për kundër asaj se gjykata e shkallës së parë përmes flet kthesës së datave 18/12/2023 dhe 21/12/2023, e ka caktuar seancën e radhës me datën 12/02/2024 dhe palët i ka ftuar në mënyrë të rregullt dhe ju ka dorëzuar ekspertiza financiare, ku nga pretendimet ankimore rezulton se përfaqësuesi i paditëses ka prezantuar në këtë seancë, por i njëjti është informuar se seanca është mbajtur me datën 06/02/2024 e që realisht kjo seancë nënkupton se është anuluar nga gjykata e shkallës së parë me rastin e dërgimit të ftesave të reja për seancën e radhës të caktuar me datën 12/02/2024, prandaj në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore të aplikohet nenit 423.3 të LPK-së e cila dispozitë parasheh: *Në qoftë se paditësi nuk vjen në seancën kryesore, edhe pse është thirrur rregullisht, konsiderohet se e ka tërhequr padinë, përveçse kur i padituri deklaron se kërkon që të zhvillohet shqyrtimi kryesor i çështjes në mungesë të paditësit.* Prandaj, shkeljet e tilla të cekura më lartë përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore që kanë pasur ndikim në marrjen e aktvendimit të ligjshëm dhe të drejtë, andaj aktvendimi i atakuar doemos është dashur të anulohet.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkeljen e dispozitave të sipërcituara, të cilat në ri procedurë duhet të eliminohen në atë mënyrë që me rastin e shqyrtimit të çështjes, udhëzohet të caktojë shqyrtimin përgatitorë/kryesor dhe të ftohen palët

Numri i lëndës: 2019:151799
Datë: 23.04.2024
Numri i dokumentit: 05608660

ndërgjyqëse në mënyrë të rregullt si dhe të vlerësohen të gjitha faktet me rëndësi vendimtare sipas kërkesave dhe kundërshtimeve të palëve, me qëllim që të nxjerrë një vendim të ligjshëm dhe të drejtë.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 208, nenit 209, par.1 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
CA.nr.3489/24, me datë 23.04.2024

Kryetar i kolegjit-Gjyqtari
Liridon Maloku